



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 55

Tiranë – E hënë, 11 prill 2016

PËRMBAJTJA

		Faqe
Ligj nr. 32/2016 datë 24.3.2016	Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve nën presion.....	3541
Ligj nr. 34/2016 datë 24.3.2016	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Çeke për mbrojtjen shoqërore.....	3548
Rezolutë e Kuvendit datë 31.3.2016	Për vlerësimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Ujit (ERRU) për vitin 2015.....	3556



LIGJ
Nr. 32/2016

**PËR GARANTIMIN E SIGURISË SË
PUNËS TË PAJISJEVE DHE
INSTALIMEVE NËN PRESION**

Në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është garantimi i sigurisë së punës të pajisjeve e instalimeve nën presion, nëpërmjet krijimit të një kuadri ligjor, i cili përcakton kushtet dhe kërkesat thelbësore që duhet të respektohen nga operatorët ekonomikë që administrojnë apo shfrytëzojnë këto pajisje e instalime.

Neni 2
Objekti

Ky ligj përcakton:

1. Kushtet dhe kërkesat kryesore të sigurisë, që duhet të zbatohen në prodhimin, montimin dhe përdorimin e pajisjeve dhe instalimeve nën presion, me qëllim garantimin e sigurisë së jetës dhe shëndetit të njerëzve, kafshëve shtëpiake, mjedisit dhe vlerave materiale, nga rreziqet e shkaktuara nga këto pajisje dhe instalime.

2. Të drejtat e kompetencat e inspektoratit shtetëror, përgjegjës për fushën e veprimtarisë së pajisjeve dhe instalimeve nën presion, si dhe të organeve kombëtare, të miratuara, e atyre europiane, të notifikuara, të vlerësimit të konformitetit, për pajisjet dhe instalimet nën presion.

Neni 3
Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Pajisje nën presion” janë pajisjet nën presion stacionar, enët e thjeshta nën presion dhe pajisjet

transportuese nën presion, me presion të lejuar mbi 0,5 bar.

2. “Pajisje nën presion stacionare” janë enët, enët e thjeshta, tubacionet, aksesoret e sigurisë dhe aksesoret nën presion, të cilët përfshijnë edhe elementet bashkuese me pjesët e tjera të instalimit, ku bëjnë pjesë edhe flanaxha, rakorde, manikota, mbështetëse, krahë të lëvizshëm etj.

3. “Enë nën presion” është një vëllim i mbyllur, i projektuar dhe i prodhuar për të mbajtur fluide që krijojnë presion mbi 0,5 bar, e cila, rast pas rasti, përfshin edhe elementet bashkuese për lidhjen me pajisjet e tjera.

4. “Enë e thjeshtë nën presion” është çdo enë e salduar, që i nënshtrohet një presioni të brendshëm manometrik mbi 0,5 bar, e cila është e përcaktuar të mbajë ajër ose azot dhe që nuk i ekspozohet flakës.

5. “Tubacione nën presion” janë tuba apo linja tubash, të destinuar për transportin e fluideve nën presion, përfshirë aksesoret e lidhjes së tyre dhe shkëmbyesit e nxehtësisë.

6. “Aksesore sigurie” janë dispozitivët e projektuar për mbrojtjen e pajisjeve dhe instalimeve nën presion nga tejkalimi i kufijve të lejuar. Këta dispozitivë përfshijnë dispozitivë për kufizimin e drejtpërdrejtë të presionit, si valvola të sigurisë, dispozitivë me disk shkatërrimi, shufra të mbërthyer, dispozitivë sigurie të komanduar (DSK); dhe dispozitivë kufizues, që aktivizojnë sisteme rregullimi ose që mbyllin ose çaktivizojnë pajisjen apo instalimin, përfshirë komutatorë të aktivizuar nga presioni, nga temperatura ose nga niveli i fluidit dhe dispozitivët e “matjes, kontrollit dhe rregullimit për sigurinë” (DMKRS).

7. “Aksesore nën presion” janë dispozitivët që kanë funksion shërbimi, vëllimi i mbyllur i të cilëve i nënshtrohet presionit.

8. “Pajisje të transportueshme nën presion” janë enët (bombolat, tubat, enë nën presion, bateritë e bombolave), cisternat e çmontueshme, kontejnerët cisternë të lëvizshëm, rezervuarët e vagonëve cisternë, cisternat e automjeteve cisternë, të cilat përdoren për transportin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre, si dhe për transportin e substancave e përzierjeve të tjera, sipas klasifikimit të bërë në marrëveshjen ndërkombëtare për transportin rrugor të mallrave të rrezikshme (ADR), përfshirë ventilat e tyre dhe aksesore të tjerë, të përdorur për transportimin e këtyre të fundit.



9. “Instalim nën presion” është një sistem i përbërë nga tërësia e pajisjeve nën presion, të montuara së bashku, i cili shërben për mbajtjen, trajtimin dhe shpërndarjen e fluideve nën presion.

10. “Fluide” janë gazet, lëngjet dhe avujt në gjendje të pastër, si dhe përzierjet. Një fluid mund të përmbajë një suspension trupash të ngurtë.

11. “Përdorim i pajisjeve/instalimeve nën presion” është vënia në shfrytëzim ose heqja nga puna, transporti, riparimi, përshtatja, si dhe mirëmbajtja e pajisjeve/instalimeve nën presion.

12. “Montimi” është bashkimi i pajisjeve nën presion dhe aksesoreve të tyre, sipas metodikës përkatëse, për të realizuar funksionin, për të cilin janë projektuar.

13. “Vënia në shfrytëzim” është fillimi i veprimtarisë, për të cilën është projektuar dhe montuar pajisja/instalimi nën presion.

14. “Heqja nga puna” është ndalimi i menjëhershëm i shfrytëzimit të pajisjeve /instalimeve nën presion.

15. “Prodhues” është personi juridik, i cili prodhon një pajisje nën presion dhe e vendos në treg këtë pajisje nën emrin apo markën e tij tregtare.

16. “Operator ekonomik” është prodhuesi apo përfaqësuesi i tij i autorizuar, importuesi, shpërndarësi dhe personi fizik apo juridik që monton dhe përdor pajisje apo instalime nën presion në funksion të një veprimtarie tregtare.

17. “Montues ose instalues” është personi apo operatori i licencuar, sipas legjislacionit në fuqi, për të kryer montime të pajisjeve dhe instalimeve nën presion.

18. “Ndalim i përdorimit të pajisjeve /instalimeve nën presion” është masa, e cila ndalon përdorimin e pajisjes/instalimit nën presion që nuk plotëson kërkesat thelbësore të sigurisë, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

19. “Mbikëqyrja e tregut të pajisjeve nën presion” janë veprimtaritë e kryera dhe masat e marra nga inspektorati shtetëror përgjegjës për të garantuar përputhshmërinë e pajisjeve/instalimeve nën presion me kërkesat ligjore në lidhje me të, me qëllim që të mos rrezikohen shëndeti, siguria ose aspekte të tjera të mbrojtjes së interesit publik.

20. “Mbikëqyrja prej organit të miratuar /notifikuar” është procesi i vlerësimit të konformitetit, i kryer nga një organ i miratuar/notifikuar, në fazën e projektimit dhe

prodhimit të një pajisjeje/instalimi nën presion, sipas përcaktimit të rregullit teknik përkatës.

21. “Organ i miratuar/notifikuar i vlerësimit të konformitetit” është organi i referuar në legjislacionin për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore, dhe i miratuar nga ministri përgjegjës, për kryerjen e vlerësimit të konformitetit të pajisjeve/instalimeve nën presion, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

22. “Certifikatë konformiteti” është dokumenti i lëshuar nga organi i miratuar/notifikuar i vlerësimit të konformitetit, në përputhje me procedurat e vlerësimit të konformitetit, të përshkruara në rregullat teknike përkatëse, i cili pasqyron rezultatet e inspektimit teknik të pajisjes/instalimit nën presion, lidhur me plotësimin e kërkesave thelbësore të sigurisë.

23. “Inspektorati shtetëror përgjegjës për pajisjet/instalimet nën presion” është organi shtetëror, në varësi të ministrisë përgjegjëse për industrinë, që kryen veprimtarinë e parashikuar në këtë ligj dhe legjislacionin tjetër të zbatueshëm.

24. “Kontrata e sigurimit të përgjegjësisë” është marrëveshja e nënshkruar ndërmjet operatorit ekonomik, për pajisjen/instalimin nën presion, me një shoqëri sigurimi, që siguron mbulimin e dëmeve ndaj jetës, shëndetit, pronës së qytetarëve, që mund të shkaktohen nga pajisjet/instalimet nën presion, të operatorëve ekonomikë që i kanë në pronësi apo i administrojnë ato.

25. “Libër i pajisjeve/instalimeve nën presion” është dokumenti, në të cilin pasqyrohen të dhënat në lidhje me parametrat teknikë, kohën e prodhimit, subjektin që e ka në pronësi/përdorim, rezultatet e inspektimeve teknike të pajisjes/instalimit nën presion. Ky dokument administrohet nga operatori ekonomik dhe vihet në dispozicion të inspektoratit shtetëror përgjegjës dhe organeve të miratuara/notifikuara të vlerësimit të konformitetit, sipas kërkesave ligjore në fuqi.

26. “Deklaratë konformiteti CE” është dokumenti i hartuar nën përgjegjësinë e vetme të prodhuesit apo, sipas rastit, të instaluesit të pajisjes/instalimit nën presion, i cili përshkruan të gjitha aktet ligjore apo nënligjore të zbatueshme ndaj pajisjes/instalimit, përfshirë edhe procedurën e vlerësimit të konformitetit, sipas moduleve përkatëse të përputhshmërisë me rregullat teknike dhe rregulloret përkatëse.



27. “Vërtetim përputhshmërie” është dokumenti i hartuar dhe i lëshuar nga organi i miratuar/notifikuar që kryen vlerësimin e konformitetit të projektit të hartuar prej projektuesit, i cili përshkruan rezultatet e përputhshmërisë me rregullat teknike të projektit të hartuar për pajisjet/instalimet nën presion, nga personat apo subjektet e licencuara, sipas legjislacionit në fuqi.

28. “Ministria” është ministria përgjegjëse për industrinë.

29. “Ministri” është ministri përgjegjës për industrinë.

KREU II

PROJEKTIMI I

PAJISJEVE/INSTALIMEVE NËN PRESION

Neni 4

Projektimi dhe shqyrtimi i projektit teknik të pajisjeve/instalimeve nën presion

1. Të gjitha pajisjet/instalimet nën presion prodhohen, montohen dhe vihen në shfrytëzim në përputhje me projektin teknik përkatës, të hartuar nga subjekte projektuese të licencuara, sipas legjislacionit në fuqi, dhe procedurën përkatëse të montimit.

2. Subjekti projektues harton projektin teknik, në përputhje me rregullat teknike, dhe mban përgjegjësi për projektin e hartuar.

3. Përpara fillimit të procedurës së montimit të pajisjes/instalimit nën presion, operatorët ekonomikë marrin masa për vlerësimin e konformitetit të tij, nga një organ i miratuar/notifikuar për vlerësimin e konformitetit, në përputhje me rregullat teknike përkatëse.

4. Organi i miratuar/notifikuar i vlerësimin të konformitetit shqyrtton përputhshmërinë e projektit të paraqitur me rregullat teknike përkatëse dhe, nëse e gjen në përputhje me to, lëshon vërtetimin e përputhshmërisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore.

5. Inspektorati shtetëror përgjegjës mbikëqyr zbatimin e këtij detyrimi nga operatorët ekonomikë përkatës, në përputhje me legjislacionin në fuqi për inspektimin.

KREU III

MONTIMI I PAJISJEVE/INSTALIMEVE NËN PRESION

Neni 5

Montimi i pajisjeve/instalimeve nën presion

1. Montimi i pajisjeve/instalimeve nën presion kryhet vetëm nga subjekte të licencuara, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Instaluesi kryen montimin e pajisjeve/instalimeve nën presion, në përputhje me rregullat e rregulloret teknike përkatëse, dhe është përgjegjës për garantimin e kërkesave thelbësore të sigurisë së montimit të pajisjes/instalimit nën presion.

3. Pasi montohet dhe përpara vënies në shfrytëzim, pajisja/instalimi nën presion i nënshtrohet inspektimit teknik prej organeve të miratuara/notifikuara.

Neni 6

Deklarata e konformitetit “CE”

1. Çdo pajisje/instalim nën presion, përpara hedhjes në treg dhe vënies në shfrytëzim, duhet të shoqërohet me deklaratën e konformitetit “CE”, të lëshuar nga prodhuesi, ku përfshihet edhe procedura e vlerësimit të konformitetit për fazën e shfrytëzimit, sipas moduleve apo rregullave teknike përkatëse.

2. Montimi i pajisjeve/instalimeve nën presion bëhet nga subjekte instaluese, të pajisura me licencat përkatëse, të cilat janë detyruara të lëshojnë deklaratën e konformitetit “CE” për instalimin nën presion, përfshirë dhe procedurën e vlerësimit të konformitetit, sipas moduleve apo rregullave teknike përkatëse.

Neni 7

Regjistrimi i pajisjeve/instalimeve nën presion

1. Para vënies në shfrytëzim, operatori ekonomik, që ka në administrim apo pronësi pajisjen/instalimin nën presion, është i detyruar ta regjistrojë atë në librin e pajisjeve/instalimeve nën presion, pranë inspektoratit shtetëror përgjegjës.

2. Regjistrimi bëhet pasi operatori ekonomik ka depozituar, pranë inspektoratit shtetëror përgjegjës për pajisjet dhe instalimet nën presion, të dhënat e pajisjes/instalimit, deklaratën e konformitetit “CE” dhe specifikimet teknike të pajisjes/instalimit nën presion. Regjistrimi përmban:



- a) numrin unik të identifikimit;
 - b) emrin dhe adresën e prodhuesit. Për rastin e instalimeve, të instaluesit ose të përfaqësuesit të tij të autorizuar;
 - c) objektin e deklaramit (identifikimin e produktit, përfshirë edhe një fotografi), në përputhje me legjislacionin përkatës, në lidhje me të;
 - ç) referencën, ndaj standardeve të harmonizuara përkatëse që janë zbatuar, ose ndaj specifikimeve teknike, në lidhje me të cilat është deklaruar përputhshmëria.
3. Inspektorati shtetëror përgjegjës për pajisjet/instalimet nën presion i ruan këto të dhëna në *data-base*-in e vet.

KREU IV
SHFRYTËZIMI DHE MIRËMBAJTJA E
PAJISJEVE/INSTALIMEVE
NËN PRESION

Neni 8

**Përgjegjësitë e operatorit ekonomik dhe
punëmarrësit për shfrytëzimin e
pajisjeve/instalimeve nën presion**

1. Operatori ekonomik përgjegjës, që vë në shfrytëzim pajisjen/instalimin nën presion, duhet:
- a) të marrë masa që të sigurojë jetën dhe shëndetin e punëmarrësve, gjatë shfrytëzimit të pajisjeve/instalimeve nën presion, në përputhje me legjislacionin përkatës për sigurinë në punë të punëmarrësve;
 - b) të vendosë në përdorim pajisje/instalime nën presion që plotësojnë kërkesat thelbësore të sigurisë, në përputhje me këtë ligj dhe legjislacionin përkatës në fuqi;
 - c) të marrë masat e duhura që pajisjet/instalimet nën presion, gjatë përdorimit, të mirëmbahen në një nivel të tillë që të plotësojnë kërkesat thelbësore të sigurisë, në përputhje me këtë ligj dhe legjislacionin përkatës në fuqi.
2. Operatori ekonomik përgjegjës harton, duke vlerësuar shkallën e rrezikut, një dokument vlerësimi dhe parandalimi të rrezikut, që përmban masa me karakter teknik e organizativ, të cilat duhet të zbatohen prej punëmarrësve dhe operuesve të pajisjeve/instalimeve nën presion, në përputhje me rregullin teknik përkatës dhe kushtet specifike të vendeve të punës së veprimtarisë.

3. Operatori ekonomik përgjegjës merr masa që punëmarrësit të disponojnë të dhënat dhe udhëzimet e duhura të përdorimit të pajisjeve/instalimeve nën presion që ata përdorin gjatë procesit të punës.

4. Të dhënat dhe udhëzimet për përdorimin e pajisjeve/instalimeve nën presion përmbajnë, të paktën, treguesit për sigurinë dhe shëndetin, për sa u përket:

- a) kushteve të shfrytëzimit të pajisjeve/instalimeve nën presion;
- b) situatave anormale të parashikueshme;
- c) dhënies së ndihmës së parë mjekësore, në rast aksidenti.

5. Të dhënat dhe udhëzimet për përdorimin e pajisjeve/instalimeve nën presion duhet të jenë të kuptueshme për punëmarrësin.

6. Operatori ekonomik ka përgjegjësi që, në çdo rast, përdorimi i pajisjeve/instalimeve nën presion të bëhet nga punëmarrës që ka përgatitje të dokumentuar me dëshmi aftësie, e cila lëshohet nga një organ i miratuar nga ministri, i akredituar për certifikimin e personelit që kryen punë me pajisje/instalime nën presion.

Neni 9

Vënia në shfrytëzim

1. Pas instalimit dhe para vënies në shfrytëzim, pajisjet/instalimet nën presion të instaluar duhet të pajisen me deklaratë konformiteti “CE”, të lëshuar nga montuesi/instaluesi, sipas parashikimeve të nenit 6, pika 2, të këtij ligji.

2. Çdo pajisje/instalim nën presion, të cilës i ndryshohet destinacioni fillestar apo tek e cila ndërhyhet, për efekt të mirëmbajtjes ose ndryshimit të skemës së funksionimit, duhet të riparohet me certifikatë konformiteti, të lëshuar nga një organ i miratuar/notifikuar i vlerësimit të konformitetit, për të vërtetuar plotësimin e kërkesave thelbësore të sigurisë së pajisjes/instalimit nën presion pas ndërhyrjes së kryer, sipas legjislacionit në fuqi.

3. Në rast se pajisja/instalimi nën presion nuk është në përputhje me kushtet thelbësore të sigurisë dhe përbën rrezik për jetën dhe shëndetin e njerëzve, vlerat materiale dhe ndotjen e mjedisit, inspektorati shtetëror përgjegjës urdhëron heqjen nga puna dhe ndalimin e menjëhershëm të përdorimit, derisa të sigurohet rikthimi i pajisjes/instalimit nën presion në kushtet e sigurisë, të vërtetuar me certifikatën përkatëse të konformitetit.



4. Përpara vënies dhe gjatë shfrytëzimit të pajisjeve/instalimeve nën presion, operatorët ekonomikë, që kanë pronësinë apo i administrojnë ato, duhet të jenë të pajisur me kontratën e sigurimit të përgjegjësive civile, e cila duhet të jetë e vlefshme gjatë gjithë periudhës së shfrytëzimit të pajisjeve/instalimeve nën presion, për të garantuar mbulimin e dëmeve që mund të shkaktohen ndaj mjedisit, jetës, shëndetit dhe pronës së qytetarëve.

5. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton kategoritë e operatorëve ekonomikë që i nënshtrohen detyrimit të përcaktuar në pikën 4, të këtij neni, si dhe kufirin minimal të përgjegjësive së tyre, që mbulohet nga kontrata e sigurimit.

Neni 10

Mirëmbajtja e pajisjeve/instalimeve nën presion

1. Operatori ekonomik, që ka në administrim apo pronësi pajisjen/instalimin nën presion, siguron mirëmbajtjen e saj, në përputhje me rregullat teknike.

2. Mirëmbajtja e pajisjes/instalimit nën presion realizohet nëpërmjet shërbimeve teknike, të planifikuara dhe të paplanifikuara, sipas nevojës. Mirëmbajtja duhet të kryhet në përputhje me rregullat përkatëse teknike të saj. Pas kryerjes së mirëmbajtjes, operatori ekonomik, që ka në pronësi apo administrim pajisjen/instalimin nën presion, kërkon inspektimin e saj, nga organet e miratuara/notifikuara të vlerësimit të konformitetit, për të kryer vlerësimin e përputhshmërisë me kriteret thelbësore të sigurisë.

Neni 11

Këqyrja e avarisë

1. Për çdo rast avarie në pajisjet/instalimet nën presion, me pasoja ndaj jetës, shëndetit, pronës së qytetarëve dhe mjedisit, operatori ose përfaqësuesi i tij njofton, sa më parë, inspektoratin shtetëror përgjegjës për pajisjet dhe instalimet nën presion, për këqyrjen e tij.

2. Ndalohet riparimi apo ndërhyrja në pajisjet/instalimet nën presion deri në përfundimin e këqyrjes nga ana e inspektoratit, përveç rastit kur inspektorati shtetëror përgjegjës jep një miratim paraprak.

3. Operatori ose përfaqësuesi i autorizuar i tij është i detyruar të vërë në dispozicion të

inspektoratit shtetëror përgjegjës për pajisjet /instalimet nën presion çdo të dhënë që i kërkohet për këtë rast.

4. Kur avaria e shkaktuar në pajisjet/instalimet nën presion shoqërohet me aksident, rrezikim të jetës së njerëzve e kafshëve apo dëmtim të rëndë të pronës, inspektorati shtetëror përgjegjës për pajisjet/instalimet nën presion bashkëpunon me organet e tjera përkatëse shtetërore për këqyrjen e avarisë.

5. Pas përfundimit të këqyrjes së avarisë, inspektorati shtetëror përgjegjës për pajisjet /instalimet nën presion harton raportin, në të cilin përcakton avarinë, shkaqet, përgjegjësitë dhe rekomandimet dhe, sipas rastit, ia përcjell atë organeve kompetente.

KREU V

MBIKËQYRJA E

PAJISJEVE/INSTALIMEVE NËN PRESION

Neni 12

Organet që kryejnë mbikëqyrjen dhe vlerësimet e konformitetit periodik e të veçanta

Pajisjet/instalimet nën presion, me qëllim verifikimin e plotësimin të kërkesave të këtij ligji, u nënshtrohen inspektimit dhe kontrolleve nga:

a) inspektorati shtetëror përgjegjës për pajisjet/instalimet nën presion, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe legjislacionit përkatës në fuqi;

b) organet e miratuara/notifikuara të vlerësimit të konformitetit, që kryejnë inspektime e kontrolle periodike dhe të veçanta të vlerësimit të konformitetit, në përputhje me ligjin për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore dhe rregullin teknik përkatës, sipas kërkesave të këtij ligji.

Neni 13

Inspektimet dhe vlerësimet e konformitetit periodik e të veçantë

1. Operatori ekonomik, që ka në pronësi apo administrim pajisjen/instalimin nën presion, është përgjegjës për kryerjen e inspektimeve apo kontrolleve periodike e të veçanta të pajisjeve/instalimeve nën presion, për vlerësimin e konformitetit dhe përputhshmërisë me kërkesat thelbësore të sigurisë, sipas rregullit teknik përkatës. Pajisja/instalimi nën presion i nënshtrohet



vlerësimin të konformitetit në mënyrë periodike dhe, në raste të veçanta, sipas parashikimeve të këtij ligji dhe rregullit teknik përkatës.

2. Rezultatet e kontrollit pasqyrohen në certifikatën e konformitetit që organi i miratuar i lëshon operatorit ekonomik. Të dhënat dhe rezultatet e kontrollit regjistrohen dhe ruhen në bazën e të dhënave të operatorit ekonomik, për një periudhë jo më pak se 10 vjet, dhe u vihen në dispozicion, sipas kërkesës, inspektoratit shtetëror përgjegjës, organeve përkatëse shtetërore, apo organeve të miratuara/notifikuara të vlerësimin të konformitetit. Organet e miratuara/notifikuara janë të detyruara të ruajnë të dhënat e inspektimeve, në bazën e tyre të të dhënave, dhe të dërgojnë, periodikisht, çdo katër muaj, informacion për to pranë ministrisë përgjegjëse dhe inspektoratit përgjegjës.

3. Ndalohet shfrytëzimi i pajisjeve/instalimeve nën presion në rast se ka përfunduar afati i vlefshmërisë së përcaktuar në certifikatën e konformitetit.

4. Ndalohet shfrytëzimi i pajisjeve/instalimeve nën presion nëse, nga kontrolli teknik periodik ose i veçantë, rezulton se ato nuk plotësojnë kushtet thelbësore të sigurisë, të përcaktuara në rregullin teknik përkatës.

5. Organi i miratuar i vlerësimin të konformitetit, që kryen kontrollin teknik periodik ose të veçantë, është i detyruar të njoftojë menjëherë inspektoratin shtetëror përgjegjës për pajisjet/instalimet nën presion në rast se, nga kontrolli teknik, rezulton se pajisja/instalimi nën presion nuk plotëson kushtet thelbësore të sigurisë, të përcaktuara në rregullin teknik përkatës.

Inspektorati shtetëror përgjegjës, në këtë rast, vendos për operatorin detyra përkatëse, të cilat duhet të zbatohen për rikthimin e pajisjes/instalimit nën presion në gjendjen e sigurisë, ose urdhëron heqjen nga puna dhe ndalimin e menjëhershëm të përdorimit, deri në rikthim në kushte të konformitetit.

Neni 14

Inspektorati shtetëror përgjegjës për pajisjet/instalimet nën presion

Organi shtetëror, i specializuar për kontrollin e veprimtarisë në fushën e projektimit, prodhimit, montimit dhe shfrytëzimit të pajisjeve/instalimeve nën presion, është inspektorati shtetëror në

varësinë e ministrisë përgjegjëse për industrinë.

Neni 15

Organet e miratuara/notifikuara të vlerësimin të konformitetit

1. Organet e miratuara/notifikuara të vlerësimin të konformitetit kryejnë kontrollin teknik periodik për vlerësimin e konformitetit, në përputhje me aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të këtij ligji dhe ligjit për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore.

2. Operatorët ekonomikë, përgjegjës për pajisjet/instalimet nën presion, marrin të gjitha masat për të kryer vlerësimin e konformitetit, gjatë fazës së projektimit e prodhimit, si dhe inspektimin teknik periodik e të veçantë të pajisjes/instalimit apo edhe aksesoreve të sigurisë nën presion, sipas përcaktimeve të rregullave teknike përkatëse.

Neni 16

Detyrat e inspektoratit shtetëror përgjegjës për pajisjet/instalimet nën presion

Inspektorati shtetëror përgjegjës për pajisjet/instalimet nën presion kryen këto detyra:

1. Ndjek zbatimin e detyrimit të operatorëve ekonomikë që pajisjet/instalimet nën presion t'i nënshtrohen vlerësimin të konformitetit nga një organ i miratuar/notifikuar.

2. Kryen inspektime tek operatorët ekonomikë privatë ose entet publike që ushtrojnë veprimtari me pajisje/instalime nën presion, ku vlerëson nëse:

a) ushtrimi i aktivitetit që shfrytëzon pajisjet/instalimet nën presion kryhet në përputhje me kërkesat e këtij ligji;

b) miratimi për zhvillimin e aktivitetit që shfrytëzon pajisjet/instalimet nën presion është marrë në përputhje me kushtet e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit;

c) është përgatitur dokumentacioni teknik i nevojshëm për vendosjen e pajisjeve dhe instalimeve nën presion;

ç) instalimi dhe testimi i pajisjeve/instalimeve nën presion është bërë në përputhje me legjislacionin dhe aktet teknike në fuqi;

d) pajisja/instalimi nën presion është mirëmbajtur rregullisht gjatë funksionimit të saj dhe nëse ajo është e kontrolluar dhe testuar, në përputhje me rregullat teknike në fuqi;

dh) personat që përdorin pajisjet/instalimet nën



presion dhe personat që punojnë në mirëmbajtjen e tyre plotësojnë kushtet e përcaktuara për këto veprimtari.

3. Mban evidenca të historikut të inspektimeve teknike, avarive të ndodhura, regjistrin të pajisjeve/instalimeve nën presion, të përdorura nga subjektet përkatëse.

Neni 17

Të drejtat e inspektoratit shtetëror përgjegjës për pajisjet/instalimet nën presion

1. Inspektorati shtetëror përgjegjës për pajisjet/instalimet nën presion ka të drejtën t'i krijohet akses në mjediset ku ndodhen pajisje/instalime nën presion në shfrytëzim, për kryerjen e inspektimit përkatës, në përputhje me programin e planifikuar, si dhe në rastet e paparashikuara, kur është shkaktuar një aksident, si rezultat i një avarie në pajisje/instalime nën presion.

2. Inspektorati shtetëror përgjegjës për pajisjet/instalimet nën presion mund të shtyjë afatin e inspektimit të planifikuar kur pajisja/instalimi nën presion është jashtë funksionit, për shkak të riparimeve apo mirëmbajtjes.

3. Inspektorati shtetëror përgjegjës për pajisjet/instalimet nën presion kërkon ndërhyrjen e forcave të rendit kur:

a) inspektori cenohet për shkak të kryerjes së detyrës;

b) nuk zbatohet, në mënyrë të përsëritur, urdhri i ndalimit të shfrytëzimit të një pajisjeje/instalimi nën presion, që përbën rrezik për mjedisin, jetën, shëndetin e pasurinë e njerëzve;

c) nuk lejohet, në mënyrë të paarsyeshme, të hyjë në mjediset ku ndodhen pajisjet/instalimet nën presion për kryerjen e inspektimit të tyre në punë.

4. Për realizimin e këtyre detyrave, inspektorati shtetëror përgjegjës për pajisjet/instalimet nën presion bashkëpunon edhe me organet e tjera shtetërore dhe të qeverisjes vendore.

5. Inspektorati shtetëror përgjegjës për pajisjet/instalimet nën presion urdhëron heqjen nga përdorimi të pajisjeve/instalimeve nën presion, në rastet kur ato nuk plotësojnë kërkesat thelbësore ligjore të sigurisë.

6. Inspektorati shtetëror përgjegjës për pajisjet/instalimet nën presion, kur ka të dhëna se në

ndonjë qendër prodhimi apo shfrytëzimi mbahen ose gjenden pajisje/instalime nën presion, të cilat nuk përmbushin kërkesat thelbësore të sigurisë, ka të drejtë:

a) të hyjë në këto qendra dhe të kryejë atje çdo inspektim që mund të jetë i nevojshëm;

b) të heqë nga puna dhe të vendosë ndalimin e menjëhershëm të shfrytëzimit të çdo pajisjeje/instalimi nën presion, e cila rezulton e pasigurt.

7. Inspektorati shtetëror përgjegjës për pajisjet/instalimet nën presion ka të drejtë të kërkojë nga organet e miratuara/notifikuara çdo informacion që ka të bëjë me fushën e inspektimit të pajisjeve/instalimeve nën presion, të cilin e përdor për qëllimin e ushtrimit të aktivitetit të vet, duke ruajtur konfidencialitetin, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 18

Kufizimet gjatë ushtrimit të detyrës dhe ndalimet në mbarim të funksionit

Përveç sa parashikohet në ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", të ndryshuar, inspektori i inspektoratit shtetëror përgjegjës për pajisjet/instalimet nën presion i nënshtrohet edhe kufizimeve të parashikuara në ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë".

KREU VI

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 19

Kundërvajtjet administrative

1. Shkeljet e mëposhtme, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë, nga inspektorati shtetëror përgjegjës për pajisjet/instalimet nën presion si më poshtë:

a) për shkelje të kërkesave të pikës 1, të nenit 4, me 500 000 lekë;

b) për shkelje të kërkesave të pikës 3, të nenit 4, me 50 000 lekë;

c) për shkelje të kërkesave të pikës 1, të nenit 5, me 200 000 lekë;

ç) për shkelje të kërkesave të pikave 2 e 3, të nenit 5, me nga 200 000 lekë për secilin rast;

d) për shkelje të kërkesave të pikës 1, të nenit 6, me 500 000 lekë;



dh) për shkelje të kërkesave të pikës 2, të nenit 6, me 500 000 lekë;

e) për shkelje të kërkesave të pikës 1, të nenit 7, me nga 50 000 lekë për secilin rast;

ë) për shkelje të kërkesave të pikës 1, të nenit 8, me 500 000 lekë;

f) për shkelje të kërkesave të pikës 6, të nenit 8, me 50 000 lekë;

g) për shkelje të kërkesave të pikës 3, të nenit 9, me 500 000 lekë;

gj) për shkelje të kërkesave të pikës 4, të nenit 9, me 500 000 lekë;

h) për shkelje të kërkesave të pikës 2, të nenit 10, me nga 500 000 lekë;

i) për shkelje të kërkesave të pikës 1, të nenit 11, me 500 000 lekë;

j) për shkelje të kërkesave të pikës 2, të nenit 11, me 500 000 lekë;

k) për shkelje të kërkesave të pikave 1, 3 e 4, të nenit 13, me nga 500 000 lekë për secilin rast.

2. Shqyrtimi i kundërvajtjeve administrative, procesi i ankimit dhe ekzekutimi i vendimeve të inspektoratit shtetëror përgjegjës për pajisjet/instalimet nën presion bëhet në përputhje me ligjin nr. 10 279, datë 20.5.2010, “Për kundërvajtjet administrative”.

3. Të ardhurat nga masat administrative të aplikuara, sipas pikës 1 të këtij neni, derdhen, tërësisht, në Buxhetin e Shtetit.

Neni 20

Përsëritja e shkeljeve

Inspektorati shtetëror përgjegjës për pajisjet /instalimet nën presion, në rast përsëritjeje të shkeljeve nga subjekti i inspektimit vendos ndalimin e ushtrimit të veprimtarisë deri në riparimin e shkeljes.

Neni 21

Publikimi

Inspektorati shtetëror përgjegjës për pajisjet/instalimet nën presion publikon, në median e shkruar dhe atë elektronike, masat e marra ndaj operatorëve ekonomikë, me qëllim informimin e publikut.

Neni 22

Miratimi i rregullave teknike dhe akteve të tjera nënligjore në fushën e pajisjeve/instalimeve nën presion

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë dhe ministrit përgjegjës për tregtinë, të miratojë rregullat teknike në fushën e pajisjeve/instalimeve nën presion, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, në përputhje edhe me ligjin nr. 10 489, datë 15.12.2011, “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, të ndryshuar.

Neni 23

Dispozita kalimtare

Deri në miratimin e organeve të akredituara, që do të kryejnë certifikimin e personelit që kryen punë me pajisje/instalime nën presion, dhe jo më vonë se 6 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji, ky funksion do të kryhet nga një komision i miratuar nga ministri përgjegjës, anëtarët e të cilit duhet të jenë inxhinierë të fushës së industrisë dhe me eksperiencë shumëvjeçare në këtë fushë.

Neni 24

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 24.3.2016

Shpallur me dekretin nr. 9504, datë 6.4.2016, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

LIGJ

Nr. 34/2016

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE REPUBLIKËS ÇEKE PËR MBROJTJEN SHOQËRORE

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,



KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Çeke për mbrojtjen shoqërore.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 24.3.2016

Shpallur me dekretin nr. 9506, datë 6.4.2016, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

MARRËVESHJE
NDËRMJET REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE REPUBLIKËS ÇEKE PËR
MBROJTJEN SHOQËRORE

Republika e Shqipërisë dhe Republika Çeke, në vijim të referuara si “Shtetet Kontraktuese”,
duke pasur si qëllim rregullimin dhe zhvillimin e marrëdhënieve ndërmjet dy shteteve në fushën e mbrojtjes shoqërore,

kanë rënë dakord si më poshtë:

PJESA I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Përkufizime

1. Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “Legjislacion”, ligje dhe rregullore të tjera kombëtare në lidhje me degët e mbrojtjes shoqërore të përcaktuara në nenin 2;

b) “Autoriteti kompetent”, ministritë përgjegjëse për degët e mbrojtjes shoqërore të përcaktuara në nenin 2;

c) “Institucion”, organi ose autoriteti përgjegjës për zbatimin e legjislacionit të përcaktuar në nenin 2;

d) “Institucioni kompetent”, institucioni me shpenzimet e të cilit sigurohen përfitimet;

e) “Përfitime”, të gjitha përfitimet e përcaktuara në nenin 2;

f) “Përfitime në natyrë”, kujdesi shëndetësor dhe lloje të tjera përfitimesh jo në para në rast sëmundjeje;

g) “Vendbanim”, vendbanimi i përhershëm;

h) “Qëndrim”, vendbanimi i përkohshëm;

i) “Periudhat e sigurimit”, periudhat e kontributit dhe periudhat e barasvlershme të përmbushura sipas legjislacionit të secilit shtet kontraktues.

2. Termat dhe shprehjet e tjera të përdorura në këtë Marrëveshje do të kenë kuptimin e përcaktuar për to në legjislacionin e secilit shtet kontraktues.

Neni 2

Fushëveprimi material

1. Kjo Marrëveshje zbatohet:

Për Republikën e Shqipërisë, me legjislacionin që rregullon:

a) Për sa i përket skemës së detyrueshme të sigurimeve shoqërore:

i) përfitimet në para për sëmundje për personat e punësuar;

ii) përfitimet në para për barrë lindje për personat e punësuar dhe të vetëpunësuar, si dhe për punëdhënësit;

iii) përfitimet në para për aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale për personat e punësuar;

iv) pensionet e pleqërisë, të invaliditetit dhe familjare për personat e punësuar dhe të vetëpunësuar, si dhe për punëdhënësit

b) Për sa i përket skemës së sigurimeve shëndetësore, përfitime në natyrë sipas sigurimit të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor;

c) Detyrimi për pagesën e kontributeve të sigurimit shoqëror dhe shëndetësor, sipas legjislacionit të përcaktuar në përputhje me pjesën II.

Për Republikën Çeke, me legjislacionin që rregullon:

a) i) përfitimet për sëmundjet dhe barrë lindjet;

ii) përfitimet për sigurimin e pensionit të pleqërisë, invaliditetit dhe pensionit familjar;

iii) përfitimet për sëmundjet profesionale dhe aksidentet në punë,

b) Detyrimin për pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore, politikën shtetërore të punësimit dhe kontributin e sigurimeve



shëndetësore sipas legjislacionit të përcaktuar në përputhje me pjesën II;

2. Kjo Marrëveshje zbatohet edhe për kodifikimin, zëvendësimin, ndryshimin ose plotësimin e legjislacionit mbi përfitimet e përcaktuara në paragrafin 1.

3. Kjo Marrëveshje nuk zbatohet për ndihmën sociale apo për skemat e përfitimit për viktimat e luftës apo pasojat e saj.

4. Kjo Marrëveshje nuk zbatohet për legjislacionin që ofron një skemë të re të mbrojtjes shoqërore, përveçse kur autoritetet kompetente kanë rënë dakord ndryshe.

Neni 3

Fushëveprimi personal

Kjo Marrëveshje zbatohet për të gjithë personat të cilët janë ose kanë qenë subjekt i legjislacionit të secilit ose të dyja Shteteve Kontraktuese, si dhe për personat e tjerë të cilëve u lind e drejta nga këta persona.

Neni 4

Trajtimi i barabartë

Përveç kur parashikohet ndryshe në këtë Marrëveshje, personat e përcaktuar në nenin 3 do të kenë të njëjtat të drejta dhe detyrime siç përcaktohen në legjislacionin e Shtetit Kontraktues për shtetasit e tij.

Neni 5

Eksporti i përfitimeve

1. Përveç kur parashikohet ndryshe në këtë Marrëveshje, të drejtat për përfitime dhe pagesat e përfitimeve në para sipas legjislacionit të njërit shtet kontraktues, nuk mund të reduktohen, ndryshohen, pezullohen ose konfiskohen për faktin se përfituesi banon në territorin e shtetit tjetër kontraktues.

2. Përfitimet e parashikuara në legjislacionin e secilit shtet kontraktues ose sipas kësaj Marrëveshjeje do t'i paguhet personit që banon në territorin e një shteti të tretë sikur të ishte shtetas i njërit prej Shteteve Kontraktues.

Neni 6

Shmangia e mbivendosjes së përfitimeve

Përveç kur parashikohet ndryshe, kjo Marrëveshje nuk mund të garantojë ose të ruajë të drejtën e dy ose më shumë përfitimeve të të njëjtit

lloj që mbulojnë të njëjtin rrezik, për të njëjtën periudhë të sigurimit të detyrueshëm.

PJESA II

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

Neni 7

Rregulli i përgjithshëm

Përveç kur parashikohet ndryshe në këtë Marrëveshje, një person që ushtron një aktivitet si i punësuar apo i vetëpunësuar në territorin e njërit prej Shteteve Kontraktuese, duhet që në lidhje me këtë aktivitet të jetë subjekt vetëm i legjislacionit të atij shteti kontraktues.

Neni 8

Punonjësit e dërguar me punë

1. Një person i punësuar normalisht në territorin e njërit prej Shteteve Kontraktuese, i cili dërgohet me punë nga punëdhënësi i tij/i saj në territorin e shtetit tjetër kontraktues për të kryer një punë të caktuar për atë punëdhënësi, do të vazhdojë të jetë subjekt i legjislacionit të shtetit të parë kontraktues njëjloj sikur personi të ishte punësuar në territorin e tij, duke pasur parasysh që periudha e dërgimit me shërbim të mos i kalojë 24 muaj dhe që ai person nuk është dërguar për të zëvendësuar një person tjetër me shërbim, periudha e shërbimit të të cilit ka përfunduar. Me qëllim zbatimin e këtij paragrafi, punëdhënësi dhe një degë e shoqërisë ose ndihmëse e punëdhënësit, sipas përcaktimit të bërë nga ligjet e shtetit kontraktues nga i cili është dërguar personi, do të konsiderohen i njëjti person, duke marrë parasysh që punësimi në territorin e shtetit tjetër kontraktues do të mbulohej nga ligjet e shtetit kontraktues prej nga ku personi ishte dërguar, pavarësisht kësaj Marrëveshjeje.

2. Paragrafi 1 i këtij neni do të zbatohet kur një person i dërguar me punë nga punëdhënësi i tij/i saj nga territori i një shteti kontraktues në territorin e një shteti të tretë, i mbuluar me sigurim të detyrueshëm sipas ligjeve të atij shteti kontraktues, ndërsa është i punësuar në territorin e shtetit të tretë, dërgohet në vazhdim nga ai punëdhënësi prej territorit të shtetit të tretë në territorin e shtetit tjetër kontraktues.

3. Një person i cili është normalisht i vetëpunësuar në territorin e njërit prej Shteteve Kontraktuese dhe që përkohësisht e transferon aktivitetin e tij të vetëpunësimit në territorin e



shtetit tjetër kontraktues, do të jetë subjekt vetëm i ligjeve të shtetit të parë kontraktues, duke marrë parasysh që periudha e aktivitetit si i vetëpunësuar në territorin e shtetit tjetër kontraktues nuk kalon 12 muaj.

Neni 9

Personeli i sipërmarrjeve të transportit ndërkombëtar

1. Pavarësisht paragrafëve 2 dhe 3 të këtij neni, një person i punësuar nga një sipërmarrje transporti ndërkombëtar e cila e ka zyrën e saj të regjistrimit në territorin e një shteti kontraktues, do të jetë subjekt i legjislacionit të atij shteti kontraktues.

2. Një person i punësuar nga dega apo përfaqësia e përhershme e një sipërmarrjeje transporti ndërkombëtar do të jetë subjekt i legjislacionit të shtetit kontraktues në territorin e të cilit është vendosur dega apo përfaqësia.

3. Një person i punësuar në territorin e një shteti kontraktues ku ai/ajo banon do të jetë subjekt i legjislacionit të atij shteti kontraktues nëse sipërmarrja e transportit ndërkombëtar, e cila e ka punësuar atë nuk ka zyrë të regjistruar apo degë ose përfaqësi të përhershme në territorin e tij.

Neni 10

Anëtarët e ekipazhit në anije

Një person, i cili kryen një aktivitet si i punësuar ose i vetëpunësuar në bordin e një anijeje që lundron nën flamurin e secilit prej Shteteve Kontraktuese, do të jetë subjekt i legjislacionit të atij shteti kontraktues.

Neni 11

Nëpunësit civilë

Nëpunësit civilë dhe personat e konsideruar të tillë do të jenë subjekt i legjislacionit të shtetit kontraktues në administratën e të cilit janë të punësuar.

Neni 12

Misionet diplomatike dhe zyrat konsullore

Anëtarët e misioneve diplomatike dhe zyrave konsullore, si dhe personeli privat i punësuar në shërbim të tyre do të jenë subjekt i dispozitave të caktuara nga Konventa e Vjenës mbi Marrëdhëniet Diplomatike, e datës 18 prill 1961 dhe Konventa e Vjenës mbi Marrëdhëniet Konsullore, e datës 24 prill 1963.

Neni 13

Përfshirjet nga dispozitat e neneve 7 dhe 12

Me kërkesë të përbashkët të të punësuarit dhe të punëdhënësit të tij ose me kërkesë të një të vetëpunësuarit, autoritetet kompetente ose institucionet e përcaktuara të të dyja Shteteve Kontraktuese mund të bien dakord të bëjnë një përfshirje nga dispozitat e kësaj pjese, për sa u përket individëve ose kategorive të personave, duke marrë parasysh që çdo person do të jetë subjekt i legjislacionit të njërit shtet kontraktues.

PJESA III

DISPOZITA TË VEÇANTA NË LIDHJE ME KATEGORITË E NDRYSHME TË PËRFTIMIT

SEKSIONI 1

PËRFTIMET E SËMUNDJEVE DHE BARRËLINDJEVE

Neni 14

Bashkimi i periudhave të sigurimit

Nëse legjislacioni i shtetit tjetër kontraktues jep të drejtën për përfitime të kushtëzuara në varësi të përmbushjes së periudhës së sigurimit, institucioni kompetent i këtij shteti duhet të marrë në konsideratë, nëse është e nevojshme, periudhat e sigurimit të përmbushura sipas legjislacionit të shtetit tjetër kontraktues, me kusht që ato të mos mbivendosen, sikur të ishin periudha sigurimi të përmbushura sipas legjislacionit të shtetit të parë kontraktues.

Neni 15

Dhënia e përfitimeve

1. Një person i cili ka kërkuar të drejtën e përfitimeve nën legjislacionin e një shteti kontraktues do të marrë në territorin e shtetit tjetër kontraktues:

a) Përfitime në natyrë nga institucioni i shtetit tjetër kontraktues në bazë të legjislacionit të tij, sikur ai/ajo të jetë i siguruar atje, por vetëm në masën e nevojshme, nëse kushtet shëndetësore të personit në fjalë kërkojnë dhënie të menjëhershme të këtyre përfitimeve;

b) Përfitime në para, drejtpërdrejt nga institucioni kompetent i shtetit të parë kontraktues, në bazë të legjislacionit të tij.



2. Përfitimet në natyrë do të jepen në territorin e shtetit tjetër kontraktues edhe përtej masës së nevojshme të parashikuar në paragrafin 1, me pëlqimin e institucionit kompetent të shtetit të parë kontraktues.

Neni 16

Sigurimi shëndetësor i pensionistëve

Personat të cilët marrin pension nga të dyja shtetet kontraktuese do të jenë subjekt i legjislacionit për sigurimin shëndetësor dhe do të kenë të drejtën për përfitime në natyrë nga shteti kontraktues në territorin e të cilit banojnë.

Neni 17

Rimbursimi i shpenzimeve të përfitimeve në natyrë

1. Institucioni kompetent i një shteti kontraktues do t'i rimbursojë institucionit të shtetit tjetër kontraktues shpenzimet e përfitimeve të dhëna sipas nenit 15, për secilin rast, duke përjashtuar shpenzimet administrative.

2. Shuma e shpenzimeve e pretenduar për rimbursim nga institucioni kompetent vendoset nga institucioni i cili ka dhënë përfitimet, me çmimet që zbatohen për dhënien e përfitimeve për të siguruarit e tij.

3. Autoritetet kompetente do të bien dakord për aspektet teknike të dhënies së përfitimeve dhe mënyrën detyruese të rimbursimit të shpenzimeve mes institucioneve të Shteteve Kontraktuese. Me qëllimin për të thjeshtësuar procedurat administrative, ata mund të bien dakord që për të gjitha rastet, ose për një grup të caktuar rastesh, do të përdoret një shumë fikse në vend të rimbursimit individual për secilin rast konkret.

SEKSIONI 2

PËRFTIMET PËR PENSION, PENSION INVALIDITETI DHE PENSION FAMILJAR

Neni 18

Bashkimi i periudhave të sigurimit

1. Nëse legjislacioni i njërit shtet kontraktues kryen marrjen, ruajtjen ose rikuperimin e një të drejte për përfitim në varësi të ekzistencës apo përmbushjes së periudhave të caktuara të sigurimit, institucioni kompetent i këtij shteti kontraktues do të marrë parasysh ekzistencën e sigurimit apo periudhat e barasvlershme të sigurimit të

përmbushura sipas legjislacionit të shtetit tjetër kontraktues, në masën që ato nuk mbivendosen, sikur të ishin sigurime të përmbushura sipas legjislacionit të tij.

2. Institucioni i secilit shtet kontraktues merr në konsideratë, gjithashtu, periudha të sigurimit të plotësuar nën legjislacionin e një shteti të tretë me të cilin ai shtet kontraktues është lidhur me anë të një instrumenti sigurimesh shoqërore, i cili parashikon bashkimin e periudhave.

Neni 19

Llogaritja e përfitimeve

1. Institucioni kompetent i shtetit kontraktues do të llogarisë shumën e përfitimt që do të jetë:

a) sipas legjislacionit që zbaton, kur kushtet për të drejtën e përfitimeve të jenë përmbushur në bazë të periudhave të sigurimit të plotësuar ekskluzivisht sipas legjislacionit të tij;

dhe

b) sipas rregullave të parashikuara nga paragrafi 2, me përjashtim kur rezultati i kësaj llogaritjeje është i barabartë ose më i ulët se rezultati i llogaritjes, sipas pikës 1, nënparagrafi "a".

2. Institucioni kompetent i shtetit kontraktues do të vendosë shumën e përfitimt duke marrë në konsideratë periudhat e sigurimit, të plotësuar nën legjislacionin e shtetit tjetër kontraktues ose një shteti të tretë, brenda kuptimit të nenit 18, si vijon:

a) llogaritet shuma teorike e përfitimt që do të ishte kërkuar, nëse të gjitha periudhat e sigurimit do të ishin përmbushur sipas legjislacionit të tij; dhe

b) më pas, mbi bazën e shumës teorike të llogaritur sipas nënparagrafit "a", përcaktohet shuma e përfitimt të pagueshëm duke aplikuar raportin e kohëzgjatjes së periudhave të sigurimit të përmbushura sipas legjislacionit të tij me periudhën totale të sigurimit.

Në mënyrë që të përcaktohet baza për llogaritjen e përfitimt, institucioni kompetent do të marrë parasysh të ardhurat e fituara vetëm gjatë periudhave të sigurimit të kryera nën legjislacionin e zbatueshëm. Ky institucion duhet të marrë parasysh këto të ardhura – të indeksuara dhe mesatare nëse supozohet nga legjislacioni në fuqi – siç janë fituar gjatë periudhave të sigurimit që janë marrë parasysh për llogaritjen e shumës teorike të përfitimt.

3. Personi në fjalë do të ketë shumën më të lartë të llogaritur në përputhje me paragrafët 1 dhe 2.



Neni 20

Periudhat e sigurimit më pak se një vit

1. Pavarësisht dispozitave të parashikuara të nenit 18, nëse kohëzgjatja e përgjithshme e periudhave të sigurimit të përmbushura sipas legjislacionit të shtetit kontraktues është më pak se një vit dhe nëse, vetëm në bazë të këtyre periudhave, nuk ekziston në bazë të legjislacionit asnjë e drejtë për përfitime, institucioni i atij shteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të japë përfitime në lidhje me këto periudha.

2. Periudhat e sigurimit, të referuara në paragrafin 1, do të merren parasysh nga institucioni i shtetit tjetër kontraktues, sikur këto periudha të ishin përmbushur sipas legjislacionit që ai zbaton.

Neni 21

Asimilimi i fakteve

1. Ngjarjet që kanë efekt juridik mbi të drejtën për përfitim, zvogëlimin, pezullimin ose shumën e përfitimeve dhe të cilat kanë ndodhur në territorin e shtetit tjetër kontraktues, do të merren parasysh në të njëjtën mënyrë sikur të kishin ndodhur në territorin e shtetit të parë kontraktues.

2. Autoriteti kompetent i secilit shtet kontraktues, në interes të kategorive të përfituesve, mund të kufizojë zbatimin e parashikimit të paragrafit 1.

Neni 22

Dispozita të veçanta në lidhje me Republikën Çeke

Një person me aftësi të kufizuar, aftësia e kufizuar e të cilit ka filluar para se ai/ajo të arrinte moshën 18 vjeç dhe që nuk ka marrë pjesë në skemën e sigurimeve për periudhën e nevojshme, do të ketë të drejtë për një përfitim të invaliditetit, me kusht që ky person të ketë vendbanimin në Republikën Çeke.

SEKSIONI 3

PËRFTITIMET PËR AKSIDENTET NË PUNË DHE NGA SËMUNDJET PROFESIONALE

Neni 23

Dhënia e përfitimeve në para

1. Përfitimet për aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale do të jepen nga institucioni kompetent i shtetit kontraktues për të cilin legjislacioni i të cilit zbatohet për personin në

momentin kur ka ndodhur aksidenti në punë ose periudha kur personi ka qenë i angazhuar në një profesion që shkakton sëmundje profesionale.

2. Nëse legjislacioni i njërit prej shteteve kontraktuese e lidh dhënien e përfitimeve me kushtin që sëmundja në fjalë diagnostikohet fillimisht në territorin e tij, ky kusht do të konsiderohet i përmbushur nëse sëmundja është diagnostikuar për herë të parë në territorin e shtetit tjetër kontraktues.

3. Nëse legjislacioni i secilit shtet kontraktues e lidh dhënien e përfitimeve me kushtin që një profesion që mund të shkaktojë sëmundje profesionale të ushtrohet për një periudhë të caktuar, do të merret parasysh çdo periudhë e një profesioni të ngjashëm e ushtruar në përputhje me legjislacionin e shtetit tjetër kontraktues.

Neni 24

Përfitimet në natyrë

Përfitimet në natyrë do të parashikohen dhe rimbursohen në bazë të pjesës së tretë – seksioni 1 i kësaj Marrëveshjeje.

Neni 25

Dhënia e përfitimeve në para për përkeqësimin e një sëmundje profesionale

Nëse një person ka marrë ose është duke marrë përfitime për një sëmundje profesionale nga një institucion kompetent i njërit prej Shteteve Kontraktuese dhe pretendon përfitime në rastin e përkeqësimit të sëmundjes së tij të shkaktuar nga angazhimi profesional në territorin e shtetit tjetër kontraktues, do të zbatohen dispozitat e mëposhtme:

a) Përfitimet jepen nga institucioni i shtetit të parë kontraktues sipas legjislacionit të tij, pa marrë parasysh përkeqësimin e sëmundjes;

b) Institucioni i shtetit tjetër kontraktues do të japë përfitimin në një shumë të barabartë me diferencën midis shumës së përfitimit të caktuar pas përkeqësimit dhe shumës së përfitimit që do të ishte dhënë para përkeqësimit, sipas legjislacionit të zbatueshëm.



PJESA IV
DISPOZITA TË NDRYSHME

Neni 26

Masat administrative dhe të bashkëpunimit

1. Autoritetet kompetente të të dyja Shteteve Kontraktuese do të rregullojnë dhe përcaktojnë masat e nevojshme për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

2. Autoritetet kompetente:

a) do të bien dakord sipas Marrëveshjes Administrative për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje;

b) do të informojnë reciprokisht njëri-tjetrin rreth ndryshimeve në legjislacionin e Shteteve Kontraktuese;

c) do të krijojnë organe ndërlidhëse, me qëllim thjeshtimin e komunikimit ndërmjet institucioneve të Shteteve Kontraktuese.

3. Autoritetet dhe institucionet kompetente të të dyja Shteteve Kontraktuese do të ndihmojnë njëri-tjetrin për çdo çështje në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje njëllor sikur çështja të cenojë zbatimin e legjislacionit të tyre. Një asistencë e tillë do të jetë falas.

4. Nëse një person që banon ose qëndron në secilin shtet kontraktues pretendon ose është duke marrë përfitime sipas legjislacionit të shtetit tjetër kontraktues dhe është i nevojshëm një kontroll shëndetësor, institucioni i vendit të banimit ose qëndrimit i shtetit të parë kontraktues do të marrë masa për kontrollin shëndetësor me shpenzimet e tij, me kërkesë të institucionit kompetent të shtetit tjetër kontraktues.

Neni 27

Përdorimi i gjuhëve zyrtare

1. Për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, autoritetet dhe institucionet e Shteteve Kontraktuese mund të komunikojnë drejtpërdrejt në gjuhët e tyre zyrtare dhe, gjithashtu, në anglisht.

2. Asnjë kërkesë ose dokument nuk do të refuzohet me arsyen së është hartuar në gjuhën zyrtare të shtetit tjetër kontraktues.

Neni 28

Përfshirjet nga detyrimet dhe vërtetimet

1. Nëse legjislacioni i secilit shtet kontraktues parashikon përfshirje, plotësisht ose pjesërisht, nga ndonjë shpenzim gjyqësor, taksat konsullore ose detyrimet administrative, përfshirje të tilla do

të zbatohen për çdo dokument të paraqitur sipas legjislacionit të shtetit tjetër kontraktues për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

2. Të gjitha deklaratimet, dokumentet dhe certifikatat e çdo lloji të kërkuara për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje do të përjashtohen nga vërtetimi i autoriteteve diplomatike dhe konsullore.

3. Kopje të dokumenteve të cilat janë të certifikuar dhe kopjet e sakta nga një institucion i njërit shtet kontraktues do të pranohen nga institucioni i shtetit tjetër kontraktues pa certifikim të mëtejshëm.

Neni 29

Dorëzimi i kërkesës ose ankesës

Çdo kërkesë ose ankesë e cila, sipas legjislacionit të secilit shtet kontraktues, duhet t'i paraqitet autoritetit ose institucionit kompetent të atij shteti kontraktues brenda një periudhe të parashikuar, do të trajtohet sikur të ishte paraqitur brenda së njëjtës periudhë autoritetit ose institucionit përkatës të shtetit tjetër kontraktues. Në raste të tilla, autoriteti ose institucioni kompetent i shtetit kontraktues, i cili merr kërkesën ose ankesën, ia kalon atë menjëherë pa vonesë autoritetit ose institucionit të shtetit të parë kontraktues, drejtpërdrejt ose nëpërmjet organeve ndërlidhëse të të dyja Shteteve Kontraktuese.

Neni 30

Kthimi i pagesave të vonuara

Nëse institucioni i shtetit kontraktues i ka paguar përfitime në mënyrë të padrejtë ose në një shumë më të lartë një personi, brenda afateve dhe kufijve të përcaktuar në legjislacionin që ai zbaton, i kërkon institucionit të shtetit tjetër kontraktues përgjegjës për pagesën e përfitimeve personit të interesuar, që të zbrësë shumën e tepërt ose të padrejtë të parave prej pagesave në vazhdim ose të prapambetura që i detyrohet personit në fjalë. Institucioni i shtetit tjetër kontraktues do të zbrësë shumën në fjalë në bazë të kushteve dhe kufizimeve në përputhje me legjislacionin që ai zbaton në të njëjtën mënyrë si të kishte bërë vetë mbipagesën dhe do t'ia transferojë shumën e zbritur institucionit që ka paguar përfitimet padrejtsisht apo më tepër.



Neni 31

Procedura të detyrueshme

1. Vendimet e detyrueshme të gjykatave të secilit prej Shteteve Kontraktuese, si dhe dokumentacioni i detyrueshëm i lëshuar nga autoritetet ose institucionet e secilit prej Shteteve Kontraktuese, do të njihen në territorin e shtetit tjetër kontraktues në përputhje me kontributet e sigurimit shoqëror dhe detyrime të tjera.

2. Njohja mund të refuzohet vetëm në rastet kur nuk përputhet me rendin publik të shtetit kontraktues në territorin e të cilit njohja e vendimit apo e dokumentit është e detyrueshme.

3. Vendimet e detyrueshme dhe dokumentacioni i njohur sipas paragrafit 1 të këtij neni do të hyjnë në fuqi në territorin e shtetit tjetër kontraktues. Procedura e hyrjes në fuqi do të kryhet në përputhje me legjislacionin që vendos për hyrjen në fuqi të vendimeve dhe dokumenteve të tilla të shtetit kontraktues në territorin e të cilit vendoset që të hyjë në fuqi.

4. Çdo lloj detyrimi që i përket institucionit të secilit shtetit kontraktues, në çdo procedurë falimentimi ose vendosje për hyrje në fuqi në territorin e shtetit tjetër kontraktues, do të ketë të njëjtin prioritet si pretendimet e barasvlershme në territorin e atij shteti kontraktues.

Neni 32

Monedha e pagesës

Pagesat në shtetin tjetër kontraktues që rezultojnë nga zbatimi i kësaj Marrëveshjeje do të bëhen në monedhë të konvertueshme.

Procedura e pagesave dhe kursit të këmbimit do të përcaktohet hollësisht në Marrëveshjen Administrative.

Çdo kontroll i monedhës së një shteti kontraktues nuk do të ndërhyjë te transferimi i fondeve që rezultojnë nga zbatimi i kësaj Marrëveshjeje.

Neni 33

Konfidencialiteti i informacionit të shkëmbyer

Përveç kur kërkohet ndryshe nga legjislacionet kombëtare të Shteteve Kontraktuese, informacioni për një individ, i cili transmetohet nga një shtet kontraktues shtetit tjetër kontraktues në përputhje me këtë Marrëveshje, do të përdoret ekskluzivisht për qëllimet e zbatimit të kësaj Marrëveshjeje. Ky informacion i marrë nga shteti kontraktues do të

udhëhiqet nga ligjet kombëtare të atij Shteti Kontraktues, me qëllim ruajtjen e privatësisë dhe konfidencialitetit të të dhënave personale .

Neni 34

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje që lidhet me interpretimin apo zbatimin e kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhet me konsultime ndërmjet autoriteteve ose institucioneve kompetente të Shteteve Kontraktuese.

PJESA V

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE DHE KALIMTARE

Neni 35

Dispozita kalimtare

1. Kjo Marrëveshje nuk do të ketë asnjë të drejtë për periudhën para hyrjes së saj në fuqi.

2. Të gjitha periudhat e sigurimit të përmbushura sipas legjislacionit të shtetit kontraktues para hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje do të merren parasysh për qëllimin e përcaktimit të të drejtave që lindin nga kjo Marrëveshje.

3. Në bazë të paragrafit 1 të këtij neni, të drejta mund të lindin nga Marrëveshja edhe në lidhje me ndonjë rast i cili mund të ketë lindur para se kjo Marrëveshje të hynte në fuqi, përveç shumë fikse.

4. Të drejtat e personave të cilët kanë përfituar pension para se kjo Marrëveshje të hynte në fuqi, me kërkesë të personave të interesuar, do të rishikohen sipas dispozitave të kësaj Marrëveshjeje. Ky rishikim nuk do të sjellë reduktim të të drejtave ekzistuese të përfituesve.

5. Në rastet kur kërkesa për përfitim ose rishikimi i saj sipas këtij neni paraqiten brenda dy vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, të drejtat e përfituara në përputhje me këtë Marrëveshje do të kenë fuqi nga ajo datë dhe ndaj personit të interesuar mund të mos zbatohet legjislacioni i shtetit kontraktues në lidhje me humbjen ose kufizimin e të drejtave ndaj personave të interesuar.

Neni 36

Ratifikimi dhe hyrja në fuqi

1. Kjo Marrëveshje është subjekt ratifikimi.

2. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit të tretë kalendarik pas muajit në të



cilin Shtetet Kontraktuese informojnë njëri-tjetrin me shkrim, se janë përmbushur të gjitha kërkesat ligjore dhe kushtetuese për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 37

Kohëzgjatja dhe përfundimi i Marrëveshjes

1. Kjo Marrëveshje lidhet për një kohë të papërcaktuar.

2. Secili prej Shteteve Kontraktuese mund ta përfundojë këtë Marrëveshje nëpërmjet një njoftimi me shkrim për shtetin tjetër kontraktues. Në këtë rast, kjo Marrëveshje do të pushojë së qeni e vlefshme ditën e parë të muajit të gjashtë kalendarik pas muajit kur i është dërguar njoftimi me shkrim shtetit tjetër kontraktues.

3. Në rast të përfundimit të kësaj Marrëveshjeje, do të ruhen të gjitha të drejtat e fituara sipas dispozitave të saj dhe të gjitha ankesat e paraqitura para fundit të vlefshmërisë së kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhen sipas dispozitave të saj. Shtetet Kontraktuese do të hartojnë një rregullore për procedurat të cilat lidhen me këto të drejta.

Në dëshmi të kësaj, duke qenë rregullisht të autorizuar për këtë qëllim nënshkruerit kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.

Nënshkruar në Pragë, më 13.10.2015, në dy kopje origjinale, secila në gjuhën shqipe, çeke dhe angleze, ku të gjitha tekstet janë njëloj autentike. Në rast mospërputhjes në përkthim, versioni në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË ENTIT RREGULLATOR TË UJIT (ERRU) PËR VITIN 2015

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë,

- Duke njohur Entin Rregullator të Ujit si një institucion të pavarur publik, përgjegjës për rregullimin dhe mbikëqyrjen e sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura në nivel kombëtar;

- Duke e konsideruar shumë të rëndësishme mbrojtjen e konsumatorit, në drejtim të cilësisë më të mirë të shërbimeve të ofruara nga operatorët në sektor;

- Duke njohur rolin e Entit Rregullator të Ujit në krijimin e një sektori ujësjellës - kanalizimesh financiarisht të qëndrueshëm, që

ofron shërbime të një cilësie të lartë, por të përballueshme për të gjithë konsumatorët;

- Duke njohur sfidat e reja të këtij sektori në kuadër të Reformës Administrative Territoriale;

- Duke konsideruar si shumë të domosdoshme kryerjen e investimeve nga operatorët për përmirësimin e shërbimeve që ata ofrojnë dhe duke qenë të vetëdijshëm për ndikimin e këtyre investimeve në rritjen e tarifave për këto shërbime;

- Duke pasur parasysh që niveli i humbjeve në rrjet dhe i ujit pa të ardhura vijon të mbetet në nivele tepër të larta, duke sjellë si pasojë mosgjenerimin e të ardhurave;

Konstaton se në vitin 2015:

- Treguesit kryesorë të performancës në sektorin UK nuk kanë shënuar progres dhe shoqëritë nuk kanë bërë përpjekjet e duhura për të arritur objektivat.

- Shoqëritë, të cilave u është miratuar ndryshimi i tarifave, përgjithësisht nuk kanë arritur objektivat e përcaktuar për Treguesit Kryesorë të Performancës (TKP).

- Me gjithë marrëveshjen e mirëkuptimit, të nënshkruar në vitin 2014 mes ERRU-së, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Institutit të Shëndetit Publik, mbi cilësinë e ujit të pijshëm, monitorimi dhe raportimi i cilësisë së ujit të pijshëm nuk është arritur.

- Shlyerja e detyrimeve të operatorëve UK ndaj ERRU-së është përkeqësuar krahasuar me një vit më parë.

- Niveli i mbulimit të kostove dhe tendenca e këtij treguesi, krahasuar me një vit më parë, nuk është pozitive, dhe mbulimi i kostove vetëm përmes rritjes së tarifave dhe pa një përmirësim të performancës ka sjellë efekte negative me ndikim të drejtpërdrejtë te konsumatorët.

- ERRU-ja ka bërë rishikimin e metodologjisë “Për vendosjen e tarifave”, bazuar në eksperiencat më të mira ndërkombëtare, e cila do të ndikojë në përmbushjen e objektivave në mënyrë të qëndrueshme dhe afatgjatë të sektorit.

- ERRU-ja ka miratuar Udhëzuesin për organizimin e seancës dëgjimore me publikun gjatë procesit të miratimit të tarifave, një hap i rëndësishëm për mbrojtjen e konsumatorit, i cili synon përmirësimin e nivelit të transparencës dhe llogaridhënies ndaj konsumatorit, si dhe rrit përfshirjen e tij në procesin e ndryshimit të tarifave.



-ERRU-ja ka miratuar ndryshimet e kontratës model për shërbime ujësjellës – kanalizime, të cilat synojnë të përmirësojnë çështje të rëndësishme të marrëdhënies konsumator – operator, siç janë matja, miratimi i tarifave, e drejta e ankesës etj.

-ERRU-ja ka miratuar dhe publikuar në faqen e saj zyrtare në internet paketën e dokumenteve tip që nevojiten për plotësimin e aplikimit për ndryshimin e tarifave, duke e bërë këtë proces më transparent dhe më të aksesueshëm për operatorët e sektorit.

-ERRU-ja ka përfunduar projektin për krijimin e një “Sistemi të raportimit rregullator” i cili do të ndikojë që të dhënat e raportuara nga shoqëritë UK të jenë më të sakta e më të besueshme.

-ERRU-ja, në kuadër të reformës territoriale, ka punuar mbi informimin e njësive të reja vendore dhe operatorët UK për njohjen e situatës së ndryshuar të pronësisë dhe problemeve e vështirësive praktike që rezultojnë si pasojë e organizimit territorial.

Kërkon nga ERRU-ja për vitin 2016:

- Në kuadër të përmirësimit të cilësisë së shërbimit ndaj konsumatorëve, përmes instrumenteve dhe strategjive rregulluese të nxisë shoqëritë UK në rritjen e vazhdimësisë së shërbimit dhe cilësinë e ujit të pijshëm. Mungesa e furnizimit të vazhdueshëm vijon të mbetet problem shqetësues, duke ndikuar edhe në cilësinë e ujit.

- Duke pasur parasysh rëndësinë dhe ndjeshmërinë e këtij sektori, si dhe të drejtën e çdo qytetari për të pasur shërbim të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura, ERRU-ja të bashkëpunojë me ministrinë e linjës, Këshillin Kombëtar të Ujit, si dhe çdo institucion të përfshirë në çështjet e ujit, për të bërë të mundur përmirësimin e performancës dhe progresin e këtij sektori.

- Përmes politikave tarifore, të nxisë shoqëritë UK për pajisjen me matës, si një proces plotësisht i arritshëm nga shoqëritë UK dhe me ndikim të drejtpërdrejtë në uljen e faturimit aforfe, i cili mbetet në nivele të larta.

- Të tregohet më efikase dhe më e kujdesshme në politikën e miratimit të rritjes së tarifave, duke e parë atë të lidhur ngushtë me rritjen e performancës së operatorëve, uljes së shpenzimeve, rritjen e efikasitetit menaxhues dhe përmirësimin e shërbimit ndaj konsumatorit.

- Të vijojë përpjekjet në mbrojtje të konsumatorëve dhe zgjidhjes së ankesave të tyre, pavarësisht rolit ndërmjetës që ka me dispozitat në fuqi dhe vonesës së ndryshimeve të pritshme ligjore.

- Të vazhdojë përpjekjet për një bashkëpunim dhe koordinim më të mirë të punës me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Institutin e Shëndetit Publik për monitorimin e cilësisë së ujit të pijshëm, si një proces që lidhet drejtpërdrejt me mbrojtjen e konsumatorëve.

- Në veprimtarinë e saj të synojë një analizë individuale të operatorëve në lidhje me objektivat e vënë, duke u fokusuar në elementet problematike të tyre dhe duke sugjeruar zgjidhje të mundshme.

- Në kuadër të sfidave të reja në sektorin UK, të rrisë dhe të forcojë kapacitetet e tij administrative dhe pavarësinë operacionale.

- Përmes të gjithë instrumenteve ligjore që disponon, të kërkojë nga shoqëritë UK që të kenë prioritet të punës së tyre evidentimin dhe eliminimin apo legalizimin e lidhjeve të paligjshme, me qëllim uljen e humbjeve në rrjet dhe uljen e ujit pa të ardhura, nivelet e larta të humbjeve kanë sjellë ndikim të drejtpërdrejtë në qëndrueshmërinë financiare të shoqërive UK.

- Duke pasur parasysh që humbjet menaxheriale të ujit janë në nivele pothuajse të njëjta me ato teknike, nëpërmjet instrumenteve dhe strategjive rregulluese të kërkojë nga shoqëritë UK një menaxhim më të mirë të shërbimit të furnizimit me ujë.

- Në kuadër të reformës së re territoriale dhe ristrukturimit të sektorit, të marrë masat e nevojshme për përmirësimin e kuadrit rregullator për sa i përket ofrimit të shërbimit UK, si dhe të mbështesë zonat e reja administrative të krijuara, në mënyrë që të sigurohet një mbulim total me shërbim ujësjellës e kanalizime të rregulluar, në të gjithë vendin.

- Përmes politikave të licencimit e atyre tarifore, të kërkojë nga shoqëritë UK hartimin e planeve të biznesit, ku në fokus të veçantë të jenë investimet në zonat e pambuluara me shërbime UK, në mënyrë që në të gjithë territorin të ofrohet shërbim i rregulluar e me standarde të njëjta.

- Përmes politikave tarifore, të nxisë shoqëritë UK në optimizimin e strukturës organizative, si dhe rritjen e efikasitetit të stafit, e cila ka një



ndikim të drejtpërdrejtë në uljen e kostove të operimit dhe mirëmbajtjes së shoqërive.

- Të bashkëpunojë me të gjithë aktorët për të qartësuar mënyrën e trajtimit dhe të kapërcimit të çështjes së përballueshmërisë, në mënyrë që të gjenden mekanizma të përshtatshëm subvencionimi, për të bërë të mundur mbrojtjen e konsumatorëve me të ardhura të ulëta dhe njëkohësisht funksionimin e operatorëve në mënyrë të qëndrueshme.

- Të intensifikojë monitorimin e shoqërive UK për të bërë të mundur vlerësimin real të punës së çdo shoqërie dhe vendosjen e objektivave konkrete dhe të arritshëm, duke pasur parasysh kapacitetet aktuale të shoqërive.

- Përmes bashkëpunimit me shoqëritë dhe me pushtetin vendor, të përmirësojë arkëtimin e detyrimeve rregullatore të prapambetura nga shoqëritë UK, si element i domosdoshëm e tepër i rëndësishëm që garanton qëndrueshmërinë financiare të ERRU-së.

- Të ushtrojë mandatin ligjor për kryerjen e inspektimeve, hetimeve, verifikimeve, kontrolleve dhe marrjes së masave konkrete në raste shkeljesh administrative nga operatorët e shërbimeve.

Miratuar në datën 31.3.2016

KRYETARI
Ilir Meta

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2016

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel: 04 2427005, 04 2427006

Çmimi 148 lekë